



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 515/5 prot.

Tiranë, më 13.11.2018

V E N D I M

Nr. 90, datë 13/11/2018

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË NJËSINË E VETËQEVERISJES VENDORE, BASHKIA ÇËRRIK DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Çërrik,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 65, datë 11.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Çërrik”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Bashkia Çërrik.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e

administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 515/1 prot., datë 11.06.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr.515/2 prot., datë 11.06.2018, “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Bashkinë Cërrik”, i është njoftuar këtij institucioni.

Bashkia përfshihet si subjekt i mbikëqyrjes së Komisionerit, në zbatim të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 515/3 prot., datë 05.10.2018, të Komisionerit, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë Cërrik, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Komisioneri konstaton se subjekti i mbikëqyrur, nuk është përgjegjës brenda afatit në lidhje me përmbylljen e fazës procedurale të dërgimit të observacioneve, megjithëse është njohur me përmbajtjen e projekt raportit dhe për këtë arsye, vlerëson si të mirëqëna dhe të pranuar nga institucioni, gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në këtë material.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projekt raportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 3257/1 prot., datë 12.10.2018, “Shkresë përcjellëse”, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 515/4 prot., datë 17.10.2018, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord me rekomandimet përkatëse për rregullimin e situatës ligjore në institute të ndryshme të ligjit dhe nuk ka bërë asnjë vërejtje në lidhje me materialin.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Cërrik, dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Cërrik, në zbatim të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas procedurave specifike të përcaktuara në ligj për punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, si më poshtë:
 - ✓ *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”;
 - ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialist Invaliditeti, pranë Njesisë Cërrik, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”;
 - ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialiste e Ndhmës Ekonomike, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”;
 - ✓ *****, në pozicionin e punës, “Specialiste për Barazinë Gjinore të shtresave në Nevojë dhe Politikat e Punësimit, në Sektorin e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”.
3. Kryetari i Bashkisë Cërrik, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat, duke ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në ligjin nr.152/2013,

“Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të cilët janë evidentuar në vijim sipas gjeneraliteteve, pozicionit të punës dhe aktit të emërimit:

- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm”. Ky punonjës ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 50, datë 13.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Specialiste e Sektorit të Auditimit të Brendshëm”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 320, datë 09.10.2017, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin e datës 03.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Specialist Informimi, në Njësinë Administrative, Cërrrik, në Sektorin e Informimit me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin e datës 15.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Specialist Informimi, në Njësinë Administrative, Klos, në Sektorin e Informimit me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun”. Ky punonjës ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin e datës 17.10.2017, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Specialist Informimi, në Njësinë Administrative, Mollas, në Sektorin e Informimit me Publikun, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Informimit me Publikun”. Ky punonjës ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 141, datë 31.05.2017, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Specialiste Kontabiliteti, në Drejtorinë e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin e datës 02.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Specialiste Mjedisi, në Sektorin e MMT dhe Kadastrës Ligjore, në Drejtorinë e Bujqësisë, MMT, Mjedisit, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 309, datë 27.09.2017, të Kryetarit të Bashkisë.
- ✓ ******, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Aplikimit të Projekteve, në Drejtorinë e Kujdesit Social, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Aplikimit të Projekteve”. Kjo punonjëse ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 270, datë 11.09.2017, të Kryetarit të Bashkisë.

4. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Cërrrik, duhet të përfundojë menjëherë procesin e vlerësimit të rezultateve të punës, sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013,

“Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar dhe në të ardhmen të respektojë afatet ligjore të parashikuara në dispozitat e mësipërme.

Njësia përgjegjëse të njoftojë të gjithë nëpunësit e ngarkuar prej ligjit për të realizuar këtë procedurë, pasi në përfundim të afatit të vendimit paralajmërues, çdo punonjës që nuk ka vepruar në përmbushje të detyrave do të mbajë përgjegjësi individuale.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
6. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Bashkia Cërrik duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të paraqesë të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
7. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Cërrik, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë dhe Ministria e Brendshme.
8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA